



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2271, datë 06.03.2013**

**Për**

**“Miratimin e dokumentit për Këshillim Publik: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 06.03.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë””, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e dokumentit për Këshillim Publik: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”,**

## BAZA LIGJORE:

1. Gërma p) e nenit 8, nenet 31-39, neni 110, 114 dhe 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (*Ligji nr.9918, i ndryshuar*);
2. Rregullore nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, miratuar me Vendim nr. 747, datë 17.07.2009 të Këshillit Drejtues të AKEP, (*Rregullore nr.9*);
3. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP,

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Dokumenti për Këshillim Publik;

si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i'u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## VËREN:

1. AKEP, në zbatim të ligjit nr. 102/2012 datë 24.10.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, çmon si të rëndësishme amendimin e Rregullores nr. 09, “Për analizën e tregut”, duke reflektuar ndryshimet e ndodhura në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 si dhe ndryshimet e ndodhura dhe te pritshme ne tregun e komunikimeve elektronike;
2. AKEP, vlerëson se projekt akti administrativ “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, duke marrë në konsideratë rekomandimet e KE dhe BEREC si dhe në përfundimet e analizave të tregjeve të kryera për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike;
3. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 1183, datë 10.03.2010, në kuadër të transparencës çmon si të arsyeshme nxjerrjen për Këshillim Publik të projekt aktit administrativ “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”,

## **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu dhe për sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, bazuar në germën p) të nenit 8, nenet 31-39, neni 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë për Këshillim Publik dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, sipas dokumentit për Këshillim Publik, bashkëlidhur;
2. Periudha e Këshillimit Publik do të jetë 30 ditë nga data e publikimit të dokumentit në Internet në faqen zyrtare të AKEP;
3. Ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr. 932, datë 29.01.2013, për administrimin e procesit të Këshillimit Publik;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al);

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Për disa shtesa dhe ndryshime në:  
RREGULLOREN NR. 9, DATË 17.07.2009 “PËR ANALIZËN E TREGUT”**

**Dokument për Këshillim Publik**

**(MIRATUAR ME VKD NR.2271 DATE 06.03.2013)**

## **I. HYRJE**

Rregullorja nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”, është miratuar nga AKEP pas një procesi konsultimi me palët e interesuara mbi një dokument të hartuar nga AKEP me asistencë të konsulencës ndërkombëtare.

Gjate periudhes 2009-2013, janë zhvilluar pothuajse për të gjitha tregjet dy raunde të plota analizash, të cilat kanë për referencë ndër të tjera edhe Rregulloren nr.9 “Për analizen e tregut”.

Duke marrë në konsiderate përfundimet e arritura në analizat e kryera gjatë periudhes 2009aktualisht, ndryshimet e ndodhura dhe te pritshme te tregut te komunikimeve elektronike si edhe ndryshimet e ndodhura nw vitin 2012 tw ligjit 9918, date 20.05.2008, “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken Shqiperise” (ligji 9918), AKEP gjykon se eshte e nevojshme qe te kryhet nje amendim i rregullores Nr.9 , datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”.

Pjesa e II këtij dokumenti për Këshillim Publik, përmban ndryshimet e propozuara duke dhënë një përshkrim të arsyeve të ndryshimeve të propozuara të Rregullores dhe pjesa III, përmban rregulloren e analizes së tregut me ndryshimet e propozuara nga AKEP. Ndryshimet e propozuara në rregullore janë shënuar me gërma italike për lehtësinë e lexuesit.

Ky Dokument Konsultimi është i disponueshëm në faqen e Internetit të AKEP <http://www.akep.al>.

Palët e interesuara që dëshirojnë të shprehin opinionet e tyre në lidhje me këtë Dokument Konsultimi ftohen të depozitojnë komentet e tyre me shkrim në AKEP.

Afati i dërgimit të komenteve nga palët është deri më 7.04.2013.

Komentet në lidhje me këtë Dokument Konsultimi mund të dërgohen në një osë disa nga menytrat dhe adresat e mëposhtëme:

a) E-mail : [info@akep.al](mailto:info@akep.al)

b) Dërgim me postë (të printuar dhe kopje elektronike):

AKEP  
Rruga Rreshit Collaku, nr.43  
Tiranë  
Shqipëri

## **II. NDRYSHIMET E PROPOZUARA**

Propozimet e AKEP per amendimin e Rregullores se vitit 2009, jane te ndara ne tre seksione:

- Ndryshimet e propozuara për shkak të ndryshimit të ligjit nr. 9918;
- Ndryshime për listën e tregjeve përkatëse;
- Ndryshime të tjera në dokument.

### **1. Ndryshimi i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008**

Ndryshimet e Ligjit nr. 9918 të miratuara me Ligj nr 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime ne Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken Shqiperise”” nuk prekin në thelb përcaktimet e Rregullores së Analizes së Tregut. Megjithatë pervec referencës së ndryshuar te Ligjit nr. 9918 (duke e zevendesuar kudo në rregullore “Ligj nr. 9918” me ‘Ligj nr. 9918, i ndryshuar”), AKEP vlerëson se është e nevojshme që në pikën 2 të nenit 2 të rregullores të meren në konsideratë edhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të BEREC<sup>1</sup>, siç është përcaktuar në pikën 1 të nenit 7 të Ligjit nr. 9918, i ndryshuar. Në këtë mënyrë, pika 2 e nenit 2 të Rregullores nr. 9 propozohet të ndryshojë si më poshtë:

#### **Ishte:**

*Gjatë zbatimit të procedurave të pershkruara në pikën 1 të ketij neni, AKEP merr në konsideratë edhe direktivat/udhezimet/rekomandimet e Bashkimit European mbi analizat e tregjeve dhe vleresimin e FNT sipas kuadrit rregullator të Komunitetit European për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike*

#### **Bëhet**

*Gjatë zbatimit të procedurave të pershkruara në pikën 1 të ketij neni, AKEP merr në konsideratë edhe direktivat/udhezimet/rekomandimet e Komisionit European dhe BEREC mbi analizat e tregjeve për vlerësimin e FNT dhe masat rregulluese sipas kuadrit rregullator të Komunitetit European për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.*

### **2. Përditësimi i listës së tregjeve përkatës të nenit 3 të Rregullores nr. 9**

Lista e tregjeve përkatëse në nenin 3 të Rregullores aktuale, përmban 18 tregje përkatës të bazuar në listen e tregjeve përkatëse të Rekomandimit të KE të datës 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC) si dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Në hartimin e listës së nenit 3 në 2009, AKEP i'u

---

<sup>1</sup> BEREC: Organi i Rregullatorëve Europeanë për Komunikimet Elektronike, është organi i krijuar nga Rregullorja (KE) nr. 1211/2009 e Parlamentit European dhe e Këshillit e 25 Nëntorit 2009.

referua listës së tregjeve përkatës të rekomandimit të KE të vitit 2003 duke shtuar tregun me pakicë të telefonisë celulare, pasi konsideroi në vitin 2009 se hartimi i listës në përputhje me rekomandimin e KE, të datës 17 Dhjetor 2007 ((2007/879/EC), nuk i përgjigjej kushteve reale të tregut Shqiptar.

Lista e tregjeve të rekomandimit të KE ne 2007, përmban 7 tregjet e mëposhtme:

- 1) Tregun me pakicë të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse për klientet familjare dhe jo-familjare;
- 2) Tregun me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendodhje fikse;
- 3) Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendodhje fikse;
- 4) Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e ndarë të pjesshem ose të plotë) nga vendodhje fikse;
- 5) Tregun me shumicë të aksesit broadband;
- 6) Tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira, pavarësisht teknologjisë së përdorur për të dhënë kapacitete me qira ose të dedikuara;
- 7) Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme.

Ndërkohë nga analizat e tregjeve të analizuara në periudhën nga viti 2009 deri aktualisht, AKEP ka arritur në përfundimet se:

1. Në dokumentin final të analizës së tregut celularë më 31.03.2010, AKEP pas aplikimit të testit të tre kriterëve arriti në përfundimin se “*Tregu me pakicë i aksesit dhe shërbimeve nëpërmjet rrjeteve mobile*” (tregu nr.8 i listës së Rregullores 2009) nuk përmbush kushtet për të qënë treg i justifikuar për ndërhyrje ex-ante. Kjo u materializua me heqjen e detyrimeve të FNT të vendosura në vitin 2007 e në vijim për AMC dhe Vodafone Albania për këtë treg përkatës. Ndërkohë AMC, Vodafone dhe EM u përcaktuan operatore me FNT për “*tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme*” (tregu nr.17 i listës së Rregullores nr. 9 ).
2. Në dokumentin final të analizës së tregut të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare, 31.10.2011, AKEP pas aplikimit të testit të tre kriterëve arriti në përfundimin se “*Tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve në rrjetet individuale celulare*” (nuk ishte pjesë e listës së Rregullores nr. 9) përmbush kushtet për të qënë treg i justifikuar për ndërhyrje ex-ante. Në analizen për FNT u konkludua se të katër operatorët celulare zoterojnë FNT dhe AKEP përcaktoi edhe masat rregulluese për operatorët për këtë shërbim;

3. Në dokumentin final të analizës së tregut celularë më 4.07.2012, AKEP pas aplikimit të testit të tre kritereve arriti në përfundimin se *“Tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike të lëvizshme”* (tregu nr.16 i listës së Rregullores nr. 9) nuk përmbush kushtet për të qënë treg i justifikuar për nderhyrje ex-ante. Kjo u materializua me heqjen e detyrimeve të FNT të vendosura në 2010 e në vijim për AMC dhe Vodafone Albania për këtë treg përkatës. Ndërkohë AMC, Vodafone, EM dhe Plus u përcaktuan operatore me FNT për *“tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme”* (tregu nr.17 i listës së Rregullores nr. 9);
4. Në dokumentin final të analizës së tregut të telefonisë fikse më datë 26.07.2010, AKEP analizoi tregjet me pakicë nr.1-6 dhe me shumicë nr.8-10 të Rregullores nr. 9, duke përcaktuar Albtelecom si operator me FNT në këto tregje dhe vendosur masat rregulluese përkatëse. Më 3.08.2012-3.10.2012 AKEP kreu konsultimin publik për dokumentin e analizës së tregut të telefonisë fikse, që përmban analizën e tregjeve me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjeve me shumicë të interkoneksionit në rrjetet fikse (origjinim, terminim dhe tranzitim), dhe konkretisht:
  - Tregu me pakicë i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (për pajtimtarë familjare dhe jo –familjarë);
  - Tregu me pakicë i thirrjeve telefonike të disponueshme për publikun nga vendodhje fikse (për pajtimtarë familjare dhe jo –familjarë);
  - Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse;
  - Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse;
  - Tregu me shumicë i shërbimeve transite në rrjetet telefonike publike fikse.

Tregjet përkatës me shumicë janë të njëjta me ato të analizuar më parë nga AKEP në vitin 2010, ndërsa tregjet me pakicë u propozuan nga AKEP për ri-segmentim në dy tregje, por përseri përmbajnë të njëjtat shërbime si të gjashtë tregjet e perkufizuar në vitin 2010. Nga komentet e palëve të interesuara u vu re se ata ishin kryesisht dakort me riperkufizimin e tregjeve me pakicë.
5. Në dokumentet finale të analizave të tregjeve të linjave me qira dhe aksesit broadband më datë 13.04.2011, AKEP analizoi tregjet 7 dhe 12-15 të Rregullores nr. 9. Keto tregje ishin të njëjtë me rekomandimin 2003, dhe Albtelecom u përcaktua me FNT në keto tregje.
6. AKEP nuk ka kryer analizë për *“Tregun kombëtar me shumicë për roamingun Ndërkombëtar në rrjetet publike të lëvizshme”* (tregu nr.18 të Rregullores nr. 9), pasi nuk ka pasur praktika të suksesshme në vende individuale dhe rregullimi në vendet e BE i



këtij tregu u krye në nivel komunitar nga KE, për shkak të problemeve për një rregullator për të aplikuar rregullim të operatoreve të vendeve të tjera.

Pas ndryshimeve të ndodhura në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri, AKEP gjykon si të arsyeshme që si referencë në rregulloren e amenduar të shërbejë lista e tregjeve të rekomandimit të vitit 2007 të KE, duke marrë në konsideratë edhe përfundimet e arritura nga analizat e kryera deri tani (të cituara më sipër). Kjo do të thote që:

- a) Lista fillestare të jetë lista me tregjet përkatës të Rekomandimit të KE, të datës 17 Dhjetor 2007 ((2007/879/EC), pra 7 tregjet e cituara me lart në këtë seksion;
- b) Listës së referuar në germen a) ti shtohen:
  - i. *Tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve në rrjetet individuale celulare;*
  - ii. *Tregu me pakicë i thirrjeve telefonike të disponueshme për publikun nga vendodhje fikse (për pajtimtarë familjare dhe jo –familjare);*
  - iii. *Tregun me shumicë të shërbimeve transite në rrjetet telefonike publike fikse;*
  - iv. *Tregun me pakicë të minimumit të linjave me qera (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qera deri në dhe përfshirë 2Mb/sek);*
  - v. *Tregun me shumicë të linjave kryesore (trunk) të linjave me qera.*

### **3. Ndryshime të tjera të propozuara**

Bazuar në propozimin e mësipërm për listën e tregjeve të rekomandimit të 2007, në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores nr. 9, është e nevojshme të zëvendësohet referenca e rekomandimit të KE 2003 me rekomandimin e KE 2007.

#### **Ishte:**

*Nëse një treg i analizuar nga AKEP nuk është pjesë e listës së Rekomandimit të KE të datës 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC), atëherë AKEP vlerëson gjithashtu nëse ky treg plotëson tre kriteret e mëposhtme...*

#### **Bëhet:**

*Nëse një treg i analizuar nga AKEP nuk është pjesë e listës së Rekomandimit të KE të datës 17 Dhjetor 2007 ((2007/879/EC), atëherë AKEP vlerëson gjithashtu nëse ky treg plotëson tre kriteret e mëposhtme...*

### **III. PROJEKT-SHTESA DHE NDRYSHIME NE**

#### **RREGULLORE NR. 9, DATË 17.07.2009**

#### **“PËR ANALIZËN E TREGUT”<sup>2</sup>**

##### **Neni 1**

##### **Objekti**

Kjo rregullore përcakton mënyrën e zbatimit të procesit të përkufizimeve të tregut dhe analizave të tregut në perputhje me nenet 31 – 39 të Ligjit 9918, datë 19.05.2008, *i ndryshuar* “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

##### **Neni 2**

##### **Metodologjia**

1. AKEP rregullisht:

- a) Përcakton tregjet e justifikuara për nderhyrje ex-ante në perputhje me nenin 32 të Ligjit nr. 9918, *i ndryshuar*;
- b) Vlerëson sipërmarresit me fuqi të ndjeshme në këto tregje në perputhje me nenin 33 të ligjit nr. 9918, *i ndryshuar*, dhe
- c) Vendos, mban, ndryshon ose anulon detyrimet rregullatore të specifikuara në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 56 të ligjit 9918, *i ndryshuar*, në perputhje me nenin 34 të ligjit nr. 9918, *i ndryshuar*;

2. *Gjatë zbatimit të procedurave të përshkruara në piken 1 të këtij neni, AKEP merr në konsideratë edhe direktivat/udhezimet/rekomandimet e Komisionit European dhe BEREC mbi analizat e tregjeve për vlerësimin e FNT dhe masat rregulluese sipas kuadrit rregullator të Komunitetit European për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;*

3. AKEP u kërkon sipërmarrësve të cilët ofrojnë shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, të paraqesin të dhënat të cilat kërkohen për të përcaktuar dhe analizuar tregjet në perputhje me nenin 16 të ligjit 9918, *i ndryshuar*. Në këto kërkesa AKEP do të përcaktojë formatin në të cilin të dhënat e kërkuara do të paraqiten si dhe do të vendosë afatin kohor për dorëzimin e tyre. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve

---

<sup>2</sup> Shtesat dhe ndryshimet janë përfshirë në draft rregullore të propozuar për amendim dhe janë me germa italiane.

elektronike janë të detyruar të paraqesin të dhënat në formatin e kërkuar dhe brenda afati të kërkuar.

### Neni 3

#### Lista e tregjeve përkatëse

1. AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të mëposhtme si tregje të mundshme për nderhyrje ex-ante në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike:
  - 1) Tregun me pakicë të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse për klientet familjare dhe jo-familjare;
  - 2) *Tregun me pakicë për shërbimet telefonike të disponueshme për publikun të ofruar nga vendodhje fikse për klientet familjare dhe jo-familjare;*
  - 3) *Tregun me pakicë të minimumit të linjave me qera (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qira deri në dhe përfshirë 2Mb/sek);*
  - 4) Tregun me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendodhje fikse;
  - 5) Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendodhje fikse;
  - 6) *Tregun me shumicë të shërbimeve transite në rrjetet telefonike publike fikse;*
  - 7) Tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qera;
  - 8) *Tregun me shumicë të linjave kryesore (trunk) të linjave me qera;*
  - 9) Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e ndarë të pjesshëm ose të plotë) nga vendodhje fikse;
  - 10) Tregun me shumicë të aksesit broadband;
  - 11) Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të levizshme;
  - 12) *Tregun me shumicë të terminimit të mesazheve SMS në rrjetet individuale të levizshme.*
2. AKEP mund të përcaktojë dhe analizojë tregje të tjera që nuk janë pjesë e listës në pikën 1, të këtij neni;
3. Përkufizimi i detajuar i tregjeve përkatëse, dimensionit gjeografik dhe i produktit/shërbimit, do të jenë pjesë e dokumentit të analizës së tregut;

4. Nëse një treg i analizuar nga AKEP nuk është pjesë e listës së *Rekomandimit të KE të datës 17 Dhjetor 2007 ((2007/879/EC)*, atëherë AKEP vlerëson gjithashtu nëse ky treg plotëson tre kriteret e mëposhtme:
  - i. Prezenca e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes;
  - ii. Një strukturë tregu e cila nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrence efektive brenda afatit kohor përkatës; dhe
  - iii. Pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marre në shqyrtim.
  
5. Në qoftë se AKEP gjatë analizimit dhe përcaktimit të një tregu arrin në përfudimin se, ky treg nuk plotëson një nga kriteret e referuara në pikën 4 të këtij neni, AKEP nuk e analizon këtë treg për fuqi të ndjeshme në treg dhe nuk vendos detyrime rregullatore në këtë treg ose anulon detyrimet rregullatore ekzistuese, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9918, *i ndryshuar*.

#### **Neni 4**

#### **Rishikimi i përcaktimit të tregut dhe analizës së tregut**

Kur gjykohet se faktet, që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, atëherë AKEP rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse.

#### **Neni 5**

#### **Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, pas miratimit të Këshillit Drejtues të AKEP.

